

**Plotësimi i Rregullës së XXVII mbi Minimumin e Pajisjeve dhe Procedurave të
Sigurimit
Autorizuar sipas Nenit 42 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/47**

1. Fushëveprimi dhe qëllimi i rregullës

Kjo Rregull është e aplikueshme për të gjithë bankat komerciale të licensuara nga Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës (AQBK). Sipas kësaj rregulle kërkohet që secila bankë të miratoj procedurat përkatëse të sigurimit për të ju kundërvënë plaqkitjes ,vjedhjes dhe për të asistuar në identifikimin dhe kapjen e personave që e kanë bërë një akt të tillë. Është përgjegjësi e Bordit të Drejtorëve të bankës që të pajtohet me këtë Rregullë dhe të siguroj se programi i sigurimit, i cili është i barabartë apo i tejkalon standardet e parashkruara në këtë rregull, është zhvilluar dhe implementuar për zyrën qendrore të bankës, filialat dhe nën-filialat.

2. Emërimi i nëpunësit të sigurimit

Bordi i Drejtorëve të bankës duhet të emëroj nëpunësin për sigurim i cili do të ketë autorizim, me aprovimin paraprak të Bordit të Drejtorëve, që të zhvilloj dhe administrojë menjëherë programin me shkrim të sigurimit, në mënyrë që të mbroj secilën zyre bankare nga plaqkitjet, vjedhjet, dhe të asistojë në identifikimin dhe kapjen e personave që e kanë bërë një akt të tillë.

3. Elementet e programit të sigurimit

Programi i sigurimit duhet që:

- Të krijoj procedurat për hapjen dhe mbylljen e biznesit dhe për ruajtjen e të gjitha valutave, letrave të negociushme me vlerë dhe gjërave të tjera të vlefshme në çdo kohë;
- Të krijoj procedurat e sigurisë për transportimin e valutave;
- Të krijoj procedurat për mbajtjen e shënimeve të ndonjë vjedhje që është bërë apo tentuar që të bëhet, ndaj zyreve të bankës.
- Të siguroj trajnimin fillestar dhe periodik të puntorëve për përgjegjësitë e tyre sipas programit të sigurimit dhe se si të sillen gjatë plaqkitjes dhe pas kryerjes së plaqkitjes; dhe
- Të siguroj zgjedhjen, testimin, operimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve përkatëse të sigurimit sikur që është specifikuar më poshtë.

4. Pajisjet e sigurimit

(a) Secila bankë duhet që së paku në baza të minimumit të ketë këto pajisje të sigurimit, siq vijonë:

- Mjetet e mbrojtjes së parave të gatshme apo mjeteve të tjera likuide, si p.sh. trezori, sefi ose hapësirat e tjera të siguruara. Trezorët dhe sefat duhet të jenë të atij lloji që kërkojnë aranzhim të dyfishtë për hyrje (p.sh. kombinimi dhe qelësi, dy qelësa, etj);
 - Sistemin e dritës për ndriqim, gjatë orëve të errësirës, në vendin përreth trezorit, nëse trezori është i dukshëm jashtë zyrës së bankës;
 - Brava të rezistueshme në prekje në dyertë e jashtme dhe në dritaret e jashtme, të dizajnuara që të hapen;
 - Mirëmbajtja e kamerave që regjistron aktivitetet në zyrën e bankës; shënimet e videosë nga kamerat duhet të mirëmbahen së paku 15 ditë.
 - Një sistem alarmi apo mjet tjetër përkatës që të njoftoj me shpejtësi zyrën më të afërme përgjegjëse për zbatimin e ligjit (policinë) për ndonjë orvatje apo kryerje të vjedhjes ose plaçkitjes .
 - Mjete transporti speciale për transportimin e parave të gatshme.
- (b) Pajisjet minimale për siguri kërkohen në të gjitha filialat dhe nënfilialat e bankave. Sistemi i sigurimit për zyret tjera të vogla bankare (p.sh dogana, qendrat e kontrollit teknik, qendrat e regjistrimit të automjeteve) që punojnë me vlerë të caktuar të parave të gatshme, do të mbetet që të vendoset nga bankat individualisht, në vlerësimin e ekspozimit të rrezikut operacional.

5. Sigurimi në mbajtjen e parave të gatshme dhe parave te gatshme në lëvizje

- (a) Bankat janë të inkurajuara që të pajisen me sigurimin “ bondi me mbulesë bankare “ që është formë speciale e bondit e dizajnuar për të siguruar bankat ndaj humbjeve nga pandershmëria e punëtorëve, vjedhjet, plaçkitjet, rrëmbimet, falsifikimet, vendosja e gabuar, dhe disa rreziqe të tjera të caktuara.
- (a) Bankat kërkohen që më së paku të kenë mbulesë sigurimi për rrezikun e trezorit (paratë e gatshme në trezor) dhe paratë e gatshme në lëvizje. Bordi i Drejtorëve të bankës duhet të themeloj politikën mbi nivelin maksimal të mbajtjes së parave të gatshme, gjë që është konsideruar si e domosdoshme për të përshatur nevojat ditore të veprimtarisë së bankës. Niveli i mbajtjes së parave të gatshme i themeluar nga Bordi i Drejtorëve, është kërkuar që të mbulohet nga sigurimi i rrezikut.

6. Raportimi

Nëpunësi i sigurimit të bankës, duhet t’i raportojë së paku një herë në vit bordit të drejtorëve të bankës mbi efikasitetin e programit të sigurimit. Materia e një raporti të tillë duhet të reflektohet në procesverbalin e mbledhjes së mbajtur të Bordit.

7. Kundërvajtjet, Gjobitjet dhe Masat Përmirësuese

Nëse kuptohet se bankat kanë bërë shkelje të kësaj Rregulle, atëherë do ti nënshtrohen masave përmirësuese dhe ndëshkimeve sipas Nenit 37.2 të Rregullores 1999/21 mbi

Licensimin, Mbikqyrjen dhe Rregullimin e Bankave. Për më tepër AQBK -ja mund të kërkojë nivel më të lartë të kapitalit për bankat që nuk përmbushin standardet e sigurisë minimale të kësaj Rregulle, në mënyrë që të kompenzohet rritja e rrezikut operacional.

8. Dispozitat kalimtare

Kërkohet që të gjitha bankat të plotësojnë kërkesat e kësaj Rregulle brenda 90 ditësh pas datës efektive të kësaj rregulle.

9. Data e hyrjes në fuqi

Bordi Drejtues i Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës e ka miratuar plotësimin e kësaj Rregulle më 4 prill 2007. Në këtë mënyrë lëshimet e mëparshme të kësaj rregulle shfuqizohen.

Michel Svetchine
Drejtor I Pergjithshem